



Këshilli i Ministrave me anë të vendimit nr. 243, datë 24.03.2020 "Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore" ("Vendimi"), ka vendosur shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Bazuar në këtë Vendim, si rezultat i kësaj gjendjeje mund të realizohet **kufizimi i disa të drejtave të garantuara në Kushtetute**, deri në masën që konsiderohet e domosdoshme për të arritur ruajtjen e shëndetit të shtetasve.

Të drejtat që mund të kufizohen janë saktësisht:

- Paprekshmëria e banesës (neni 37);
- E drejta e zgjedhjes së vendbanimit dhe lëvizja e lirë (neni 38);
- Shpronësimi kundrejt një shpërblimi të drejtë (neni 41 pika 4);
- E drejta për të zgjedhur lirisht profesionin (neni 49);
- E drejta e grevës (neni 51).

Ky Vendim parashikon detyrime specifike për institucionet publike, strukturat operationale të sistemit të mbrojtjes civile, subjektet private dhe gjithë shtetasit. Konkretisht, Vendimi ndër të tjera, parashikon se:

A Institucionet Publike:

- të realizojnë plane organizative dhe të vënë në dispozicion burimet njerëzore e logjistike;
- të kufizojnë aksesin në ambiente publike;
- të ndalojnë tubimet, manifestimet dhe grevat;
- të kufizojnë aktivitetet në minimumin e domosdoshëm për të gjitha organet publike;
- të vendosin në karantinë të gjithë personat e konfirmuar ose të dyshuar dhe të garantojnë kushtet dhe stafin e kualifikuar për kurim të specializuar në qendrat e karantinës.

B Strukturat Operacionale të sistemit të mbrojtjes civile:

- të aktivizojnë dhe të organizojnë procedurën e karantinës për popullsinë e rrezikuar;
- të organizojnë kontrole të njëanshme të banesave dhe objekteve private për evidentimin dhe trajtimin e personave të prekur nga virusi;
- të kufizojnë zhvillimin e aktiviteteve ekonomike për subjektet private në përputhje me nevojat e diktuar nga fatkeqësia natyrore;
- të organizojnë procedurat e detyruara për kryerjen e shërbimeve funerale.



C **Subjektet Private:**

- të respektojnë procedurat dhe masat për karantinën;
- të informojnë lidhur me të dhënat që ndihmojnë institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile;
- të përfshihen në detyra të veçanta, në përputhje me përgatitjen dhe aftësitë e tyre;
- të mbyllin ose të kufizojnë përkohësisht veprimtarinë e tyre;
- të mos vjelin tarifën e kalimit rrugor për mjetet e angazhuara në përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

D **Shtetasit:**

- të zbatojnë urdhrat, masat dhe udhëzimet e autoriteteve të mbrojtjes civile;
- të informojnë dhe ndihmojnë institucionet publike dhe strukturat e mbrojtjes civile duke u përfshirë në detyra të veçanta në përputhje me përgatitjen dhe aftësinë e tyre.

Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile (KNEC), është organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve financiare e materiale për përballimin e fatkeqësisë natyrore.

Vendimi shpreh gjithashtu se gjitha të drejtat dhe liritë e kufizuara me akte, të dala në zbatim të ligjit nr.15/2016, "Për Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe Sëmundjeve Infektive", të ndryshuar, dhe me aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për Marrjen e Masave të Veçanta Administrative gjatë kohëzgjatjes së Periudhës së Infeksionit të Shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar, mbeten në fuqi.



The Council of Ministers, by Decision no. 243, dated 24.03.2020 “On the Declaration of the State of Natural Disaster” (the “Decision”), has decided to declare the state of natural disaster throughout the Republic of Albania due to the epidemic caused by COVID-19.

Based on such Decision, because of this situation, **some of the rights guaranteed by the Constitution may be restricted** to the extent considered necessary to achieve the protection of the health of citizens.

The rights that can be restricted are exactly:

- The inviolability of residence (article 37);
- The right to choose residence and freedom of movement (article 38);
- Expropriation for a just reward (article 41, paragraph 4);
- The right to freely choose a profession (article 49);
- The right to strike (article 51).

This Decision provides for specific obligations for public institutions, civil defense system operational structures, private entities and all citizens. Specifically inter alia it provides that:

A Public Institutions:

- to carry out organizational plans and make available human and logistical resources;
- to restrict access to public places;
- to stop gatherings, manifestations and strikes;
- to limit activities to the minimum necessary for all public authorities;
- to quarantine all confirmed or suspected persons and guarantee all the necessary conditions and qualified staff for specialized treatment at quarantine centers.

B Operational Structures of the Civil Protection System:

- to activate and organize the quarantine procedure for vulnerable populations;
- to organize controls on housing and private facilities to identify and treat persons affected by the virus;
- to restrict economic activities of private entities in accordance with the needs dictated by the natural disaster;
- to organize the procedures required for the funeral service.



C Private entities:

- to respect all quarantine procedures and measures;
- to provide necessary information to civil protection institutions and structures;
- to be involved in specific tasks, in accordance with their preparation and skills;
- to close or temporarily limit their activity;
- to suspend the collection of road toll charges for vehicles engaged in coping with the natural disaster.

D Citizens:

- to comply with the orders, measures and instructions of the civil protection authorities;
- to inform and assist public institutions and civil protection structures by engaging in specific tasks in accordance with their preparation and skills.

The Inter-Ministerial Committee on Civil Emergencies (KNEC), is the highest body for coordinating the actions of state institutions and private entities, as well as for the financial and material resources for dealing with the natural disaster.

The Decision also states that all rights and freedoms restricted by acts, enacted pursuant to law no. 15/2016, *“On the Prevention and Fighting of Infectious Diseases”*, as amended, and by Normative Act no. 3, dated 15.03.2020, *“On Special Administrative Measures during the Infection Period caused by COVID-19”*, as amended, shall continue to remain in force.